

20222393463

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHOQATA DHE FONDACIONE

Neni 1

Në Ligjin e Shoqatave dhe të Fondacioneve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” 52/10, 135/11 dhe 55/16), në nenin 4, paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Ndalohet regjistrimi i organizatës dhe themelimi i organizatës, nëse emërtimi, emri, emri i shkurtër, programi, qëllimet, aktivitetet dhe veprimi i saj, kanë për qëllim rrënimin e dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, nxitjen dhe thirrjen e agresionit ushtarak dhe ndezjen e urrejtjes nacionale, racore dhe fetare ose mosdurimit tjetër, jotolerancë, urrejtje, gjenocid, shfarosje, përhapje ose mbështetje, nxitje dhe miratim i fashizmit, nazizmit, nacional-socializmit dhe rajhut të tretë, ndërmarrja e aktiviteteve që lidhen me terrorizmin, ndërmarrja e aktiviteteve që janë në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjin dhe ndërmarrja e aktiviteteve që cenojnë liritë dhe të drejtat e personave të tjerë”.

Neni 2

Në nenin 8 shtohet paragraf i ri (4), që thotë:

„(4) Si emër, emër i shkurtër dhe/ose emërtim i organizatës, nuk mund të përdoren emra, mbiemra, nofka, pseudonime, shkurtesa dhe nistore të personave të cilët në çfarëdo baze, mënyre apo forme, kanë qenë ose janë të lidhur me mosdurim racor, fetar, nacional, etnik dhe mosdurim tjetër, jotolerancë, gjenocid, shfarosje, përhapje ose mbështetje të fashizmit, nazizmit, nacional-socializmit dhe rajhut të tretë”.

Paragrafi (4) bëhet paragrafi (5).

Neni 3

Pas nenit 9, shtohen titulli i ri 8-a dhe dy nene të reja 9-a dhe 9-b, që thonë:

“8-a Përdorimi i emrit të personalitetit historik

Neni 9-a

(1) Për përdorimin e emrit, mbiemrit, pseudonimit, nofkës, shkurtesës ose nistoreve të personalitetit, pëlqim jep ministri i Drejtësisë, pas mendimit pozitiv të marrë më parë të Komisionit për Përdorimin e Emrave të Personaliteteve (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni i përdorimit të emrave).

Komisioni për Përdorimin e Emrave

Neni 9-b

(1) Komisioni i përdorimit të emrave nga neni 9-a i këtij ligji e formon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Komisioni i përdorimit të emrave përbëhet nga pesë anëtarë, edhe atë:

- një anëtar i Ministrisë së Drejtësisë, me propozim të ministrit të Drejtësisë,
- një anëtar i Ministrisë së Kulturës, me propozim të ministrit të Kulturës,
- një anëtar i Institutit të Historisë Nacionale,
- dy anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

(3) Kryetari i Komisionit të përdorimit të emrave, zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Komisionit të përdorimit të emrave me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(4) Punët profesionalo-administrative të Komisionit të përdorimit të emrave i kryen sekretari i Komisionit të përdorimit të emrave, të cilin nga radhët e nëpunësve administrativë të punësuar në Ministrinë e Drejtësisë e emëron ministri i Drejtësisë.

(5) Komisioni i përdorimit të emrave jep mendim për përdorimin e emrit, emrit të shkurtuar ose emërtimit të organizatës nga neni 9-a i këtij ligji.

(6) Komisioni i përdorimit të emrave për punën e tij miraton rregullore.

(7) Kushtet hapësinore dhe teknike për punën e Komisionit të përdorimit të emrave i siguron Ministria e Drejtësisë.

(8) Llojin, lartësinë dhe kriteret e kompensimit për Komisionin e përdorimit të emrave i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Neni 4

Në nenin 65 shtohet nënparagraf i ri 6, si vijon:

„- emërtimin, emrin, emrin e shkurtër, programin, qëllimet, veprimtaritë shkaktojnë mosdurim racor, fetar, nacional, etnik dhe mosdurim tjetër, gjenocid, shfarsosje, përhapje ose mbështetje të fashizmit, nazizmit, nacional-socializmit dhe rajhut të tretë”.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 5

Organizatave të regjistruara në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqatave dhe të Fondacioneve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 52/10, 135/11 dhe 55/16), janë të obliguara në afat prej tre muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t’i harmonizojnë emrin dhe/ose emërtimin, emrin e shkurtuar, programin, qëllimet dhe veprimtaritë, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Organizatave të regjistruara në pajtim me dispozitat e Ligjit të Shoqatave dhe të Fondacioneve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 52/10, 135/11 dhe 55/16) të cilat nuk do t’i harmonizojnë emrin dhe/ose emërtimin, emrin e shkurtuar, programin, qëllimet dhe veprimtaritë në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, fshihen nga regjistri, në bazë të vendimit për mosharmonizim të miratuar nga ministri i Drejtësisë, pas marrjes së mendimit negativ nga komisioni nga neni 9-a të këtij ligji.

Vendimi nga paragrafi (2) i këtij neni, miratohet në afat prej katër muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Organet kompetente nga neni 9-b i këtij ligji do t’i propozojnë anëtarët te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i propozimeve, e formon Komisionin e përdorimit të emrave.

Neni 7

Procedurat e filluara për regjistrimin e organizatës dhe themelimin e organizatës në pajtim me Ligjin e Shoqatave dhe të Fondacioneve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 52/10, 135/11 dhe 55/16), deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.